



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.38

Prishtinë, më 20.1.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Mufera Shinik, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të OSBE-së, KDI, NDI, Besa Shahini, Zyra e Presidentes dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.12.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.12.2015

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 9.12.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015

Nait Hasani, tha se lidhur me punën e bërë nga ana e Komisionit për vitin 2015, jemi angazhuar bashkërisht dhe është bërë mjaft punë, ka mbetur për të vazhduar me shqyrtimin e disa projektligjeve nga viti i kaluar, si dhe përfundimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjeve të filluara nga viti i kaluar..

Me fillimin e sesionit pranveror të punës, paraprakisht kërkoi që anëtarët e Komisionit që vijnë nga partitë e opozitës t'i përgjigjen ftesës së Komisionit për pjesëmarrje në punën e përbashkët, me qëllim të japin kontributin e tyre në Komision.

Salih Morina, në diskutimin e tij, tha se viti i kaluar do të kujtohet si vit sfidues, duke pasur parasysh situatën e krijuar gjatë muajve të fundit. Sa i përket punës së Komisionit, tha se janë trajtuar çështjet dhe janë adresuar sipas agjendës së paraparë. Ai tha se duhet të angazhohemi që të punojmë sipas prioritetëve, të ftohen ministrat e linjës, të diskutojmë lidhur me prioritetet për këtë vit, si dhe të kërkohet nga ministri i MASHT-it, që Projektligjin për njohjen e stazhit të punëtorëve të arsimit nga viti 1990 deri më 1999, ta procedojë sa më parë në Kuvend.

Bekim Haxhiu, tha se si Komision kemi dhënë kontributin bashkërisht me anëtarët nga radhët e opozitës, të cilët njëkohësisht i ftoi të marrin pjesë në mbledhje të Komisionit, në mënyrë që së bashku të trajtojnë çështjet në Komision. Sa i përket punës së Komisionit, tha se MKRS-ja nuk ka proceduar me kohë projektligjet e parapara me programin legjislativ, siç është rasti i projektligjit për sponsorizimet dhe donacionet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Shpejtim Bulliqi, tha se anëtarët e Komisionit kanë dhënë kontributin e tyre në çështjet për të cilat është diskutuar në Komision. Gjithashtu, kërkoi që anëtarët e Komisionit nga ana e opozitës, të bashkëngjiten në punën e Komisionit dhe bashkërisht të kontribuojnë në çështjet që ndërlidhen me punën e Komisionit.

Sergjan Popoviq, tha se si Komision kemi dhënë kontributin tonë dhe vlerësoi çështjen e njohjes së diplomave të Universitetit të Mitrovicës, në veri, nga ana e MASHT-it dhe shpreson në angazhimin e përbashkët për këtë vit.

4. Të ndryshme

Bekim Haxhiu, propozoi që mbledhjet e Komisionit të mbahen ditën e martë.

Komisioni përkrahu propozimin dhe vendosi që mbledhjet e Komisionit të mbahen ditën e martë, me fillim nga ora 11:00.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit u caktua për ditën e martë, më 26.1.2016, me fillim nga ora 11:00, ku do të shqyrtohet Projektligji për profesionet e rregulluara.

Komisioni, ditën e mërkurë, më 27.1.2016, do të mbajë dëgjim publik, lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar, ku do të ftohen përfaqësues nga MASHT-i, Inspektorati i Arsimit dhe drejtorët e DKA-së.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani